# AKT - THEMELIMI

Sot, më datë 20 /01/1995 ( nëntëdhjetë e pesë), unë Shpëtim Protoduari, idatëlindjes 1973 , lindur dhe banues në qytetin Berat, me dëshirën time, meqënëse i plotësoj kushtet e parashikuara nga ligji tregtar, mora vendim që të krijoj si " Ortak i vetëm " shoqërinë private me përgjegjësi të kufizuar " VAKËFI" SH.P.K.

Qendra e shoqërisë " VAKËFI" SHPK, është aktkualisht në qytetin e Beratit.

Kapitali fillestar i shoqërisë " VAKËFI" SHPK, është 100.000 lek

Kohë zgjatja e shoqërisë " VAKËFI" SHPK, është mbi 10 vjet, ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë.

Shoqëria private " VAKËFI" SHBK, është person juridik,aktivitet saj zhvillohet në përputhje me këtë akt themelimi,si dhe statutin që i bashkëlidhet këtij akti.

Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është në fushën e tregtisë së artikujve ushqimor e industrial, bujqësor e blegtoral, artikuj elektrik e elektroshtepijak, pjesë këmbimi, material ndërtimi, pije alkoolike, bimë medicinale e medikamente dentare, me shumicë e pakicë eksport- import.

Kapitali i shoqërisë " VAKËFI" SHPK, do të depozitohet në llogorinë rjedhëse Nr.740/116, pranë Bankës shtetit Shqiptar Berat.Nuk ka asnjë lloj kufizimi për shtesa të kapitalit fillestar.

Këtë aktivitet do ta ushtrojë si " ORTAK i VETËM" në shoqërinë tregtare " VAKËFI" SHPK, Berat.

Ky akt themelimi mbështet në kërkesat e ligjës Nr.7512 datë 10.VIII.1991 e Nr.7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare private" dhe pasi të regjistrohem si person juridik në organet kompetente; Gjykatë të rrethit Tiranë, zyrën përkatëse të tatimeve, do të filloj zhvillimin e aktivitetit sipas objektit të shprehur në statut e vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik të shoqërisë " VAKËFI" SHPK,Në aktivitetin tim në këtë shoqëri tregtare do ti përmbahem statutit të hartuar për këtë qellim dhe do respektoj si dispozitat ligjore në fuqi dhe ato që më vonë do dalin, për ushtrimin e veprimtaris private në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar " VAKËFI" SHPK.

Shoqëria private drejtohet nga administratori i saj që është Ortaku i vetëm Shpëtim Protoduari.

Akti themelimit u redaktua në tri kopje dhe nënshkruhet rregullisht para noteres.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË " VAKËFI" SHPK.

/ Shpëtim Protoduari/

STATUT

I

SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE " VAKËFI " SH.P.K.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË LEONORA HALILI NOTERE TIRANË

FORMOHET - Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private " VAKËFI" SH.P.K., eksport - import, me ortak të vetëm Shpëtim Protoduari, i datëlindjes 1973, lindur dhe banues në qytetin Berat.

VEND QËNDRIMI - Neni 2

Vend qëndrimi i shoqërisë " VAKËFI" SH.P.K, është në qytetin e Beratit, lagje

Shoqëria në zhvillimin e aktivitetit të saj mund të hapë dhe vend qëndrime të tjera, operative, filiale, agjensi, në gjithë territori in e vendit, si dhe jashtë Shqipërisë me miratimin e organeve përkatëse.

KOHË ZGJATJA

Neni 3

Kohë zgjatja e shoqërisë " VAKËFI" SHPK, është mbi 10 vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë ekonomiko tregtare i shoqërisë " VAKËFI" SHPK, është për sa vijon:

Tregton me shumicë e pakicë artikuj ushqimor e industeial, eksport- import.

Tregton me shumicë e pakicë artikuj blegtoral e bujqësor.

Tregton materiale të ndryshme ndërtimi, elektrike, elektroshtepijake, eksport- import, si dhe investime në ndërtime banesash.

Tregton pije alkoolike, bimë medicinale, lekurë, medikamente dentare , artikuj kozmetikë e tj. me shumicë e pakicë, ekport- import.

Megjithë atë shoqria ka të drejtë të shtoj objektin e aktivitetit të saj me vendim të Gjykatës së rrethit Tiranë.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqërisë " VAKËFI" SHPK, është 100.000 lekë, i formuar në masë të plotë nga ortaku i vetëm Shpëtim Protoduari.

Neni 6

Kapitali mund të shtohet sipasvendimeve që do të marrë pronari i saj.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 7

SHPK, " VAKËFI" deklarohet e krijuar; në zbatim të plotë të

normat që përmban ky statut ,dhe ato të legjislacionit Shqiptar në fuqi e ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 e akteve të tjera ligjore e nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Ajo fiton zotsinë për të vepruar me regjistrimin esajë si person juridik në Gjykatë të rrethit Tiranë, ndërsa aktivitetin privat me regjistrimin në organet përkatëse financiare të rrethit ku ajo ka selinë ( qendrën) e aktivitetit të saj.

Neni 8

Shoqëria " VAKËFI" SHPK, ka vulën e saj, me përmbajtje shoqëria " VAKËFI" SH/P.K., import- eksport Berat.

Neni 9

Shoqëria merr përsipër të drejta dhe detyrime, përgjigjet për detyrimet e saj kontraktore e jashtë kontraktore brenda kapitalit të saj.Ortaku i vetëm i shoqërisë mbart rezikun e veprimtarisë së shoqërisë në nivelin e shumës së mjeteve të investuara.

Neni 10

Shoqëria " VAKËFI" SHPK,është pronë e Zotit Shpëtim Protoduari, themeluesi i saj.Ai merr vendime në zbatim të ligjeve në fuqi dhesipas këtij statuti; të cilat janë të detyrushme për të gjithë të punësuarit në këtë shoqëri.

Zoti Shpëtim Protoduari, si pronar i shoqërisë është njekohësisht dhe administrator i saj.

Neni 11

Administratori i shoqërisë sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë, emron administrator, si dhe punëson punëtor të veprimtarive të ndryshme ekonomike të përmendura në nenin 4 të këtij statuti.

Neni 12

Adminstratori dhe përfaqsuesi i ngarkuar prej tij, janë të veshur me gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa asnjë lloj kufizimi.Ata kryejnë të gjitha aktet që janë të nevojshme për realizimin e detyrave të shoqërisë.Ata kanë të drejtë midis të tjerave, të blejnë e të këmbejnë pasuri , të lidhen me shoqëritë e tjera vendëse dhe të huaja, brenda e jashtë vendit, të kryejnë çdo lloj veprimi pranë gjitha zyrave private apo shtetërore, që kanë të bejnë me garancitë, hipotekat, të kryejnë veprime depozitimi pranë instituteve bankare e financiare, kreditime e pagessa, arkëtime e tj.

Neni 13

Përfaqsimi i shoqërisë " VAKËFI" SHPK, i përket vetëm administratorit dhe përfaqsuesit të caktuar prej tij.Ata kanë të drejtën e përfaqsimit të shoqërisë në organet gjyqsore e administrative , të

caktoj persona të tjerë me prokurë të posaçme, si dhe avokat për çështje në Gjykim.

MARDHËNIET E PUNËS

Neni 14

Mardhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk rregullohen në kontratën e punës dhe për konflikte, zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit Shqiptar.

Neni 15

Administratori i shoqërisë emron përfaqsuesin, të cilit në aktin e emrimit i përcakton detyrën dhe pagën. Po kështu, edhe për punëtorët, shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit në republikën e Shqipërisë, si dhe të sigurimeve për ata.

Neni 16

Përfaqsuesi nuk mund të marrë cilësinë e ortakut në shoqëri dhe as të ushtrojë aktivitet konkurues të çdo lloji për llogori të tij ose të të tretëve, përveçëse rasteve të autorizuara nga administratori.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 17

Veprimet ekonomiko financiare të shoqërisë mbyllen më 31/dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe administratori nxjerr bilancin kontabel të shoqërisë dhe llogorinë fitim humbje, mbështetur në rregullat e mbajtjes së kontabilitetit, për subjektet private të përcaktuara nga organet kompetente të sistemit fiskal. Bilanci kontabel miratohet nga administratori i shoqërisë, i cili vendos për krijomin e fondeve të nevojshme për zhvillimin e garancinë e veprimtarisë së shoqërisë, fondin e akumulimit, fondin rezervë e tj.

Neni 18

Të ardhurat neto, pas veçimit të fondeve ligjore të përmbushura në nenin 19 dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale nga fitimi, i mbeten në përdorim pronarit të shoqërisë?

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Neni 19

Shpërëbrja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfardo shkaku, si humbje e kapitalit, pamundësi veprimtarie e tj. Në këtë rast pronari i shoqërisë vendos për mënyrën e likujdimit dhe cakton një ose më shumë likujdatorë. Këta tregojnë kujdes që shoqëria të likujdojë më parë detyrimet që u ka personave të tretë fizikë e juridik.

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 20

Për sa nuk është shprehur në këtë statut, i referohet plotë-

simeve nga pronari i shoqërisë, si dhe ligjeve përkatëse në fuqi.

Neni 21

Ky sttatut përpilohet në katër kopje, njëra mbahet në dokumentac cionin e shoqërisë, të tjerat në organet kompetente përkatëse, sipas ligjeve për SH.P.K.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË " VAKËFI "SHPK.
/ Shpëtim Protoduari /

Republika e Shqipërisë
Ministria e Drejtësisë
N O T E R I A
Nr. 285 Rep.
Nr. 69 Kol.

V E R T E T I M

Në Tiranë, sot, më datë 20/01/1995 ( nëntëdhjetë e pesë), në zyrën e Noterisë Tiranë, para mejet noteres, u paraqit personalisht Shpëtim Protoduari, për identitetin e të cilit u sigurova sipas letërnjoftimit të tij,person madhor me zotësi juridike të plotë për të vepruar, i cili deklaroi se ky statut i redaktuar jashtë kësaj zyre shpreh hë vullnetin e tij të lirë e të plotë dhe nënshkruhet rregullisht, si dhe unë noterja e vertetoj sipas ligjës.

N O T E R E